



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

Data 20.03.2023

Nr: 28

Ora: 15:00

VENDIM

PËR MOSPRANIMIN PËR SHQYRTIM TË KËRKESËS ANKIMORE NR. 34, DATË 17.03.2023, TË DEPOZITUAR NGA PARTIA BINDJA DEMOKRATIKE

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 20.03.2023, me pjesëmarrjen e:

Elvin LAKO	-	Relator
Elvis ÇEFA	-	Anëtar
Ilirjan RUSMALI	-	Anëtar
Koli BELE	-	Anëtar
Ledio BRAHO	-	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

KËRKUES: Partia Bindja Demokratike, përfaqësuar nga z. Fabian Topollari

OBJEKT: Korrigjim dhe kundërshtim i vendimit nr. 170, datë 11.03.2023, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për shqyrtimin e kërkesës së partisë politike “Bindja Demokratike”, për regjistrimin si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.

BAZË LIGJORE: Nenet 21, 123/1, 124, 126 dhe 130 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe nenet 10, dhe 17 të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020, të Komisionit Rregullator, “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”.

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur,

VËREN:

Partia “Bindja Demokratike” ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën ankimore, e cila në respektim të kriterëve të përcaktuara në nenin 127, të Kodit Zgjedhor, është regjistruar në regjistrin e ankimeve zgjedhore, me nr. 34 regj., datë 17.03.2023. Në mbledhjen e datës 20.03.2023, ora 15:00, pas relatimit të z. Elvin Lako, u konstatua se kërkesa ankimore nr. 34, i plotësonte elementët e formës të parashikuara në nenin 126, por jo elementët e përcaktuar në nenin 130, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, përkatësisht shkronja “c” të këtij neni, pasi vendimi i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve është marrë në datën 11 Mars 2023, dhe kërkesa ankimore është paraqitur në datën 17 Mars 2023, përtej afatit ligjor për ankimin. Në mbështetje të nenit 17, pika 3, shkronja “b”, të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020, të Komisionit Rregullator “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”, kërkesa ankimore nuk duhet të kalohet për shqyrtim.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 21, pika 1, shkronja “b”, dhe 129, pika 3, shkronja “b” të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, KAS-i

V E N D O S I:

1. Mospranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 34, datë 17.03.2023, të paraqitur nga Partia “Bindja Demokratike”.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor të Gjykatës së Apelit Administrativ brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e tij.

Elvin LAKO - **Relator**

Elvis ÇEFA - **Anëtar**

Ilirjan RUSMALI - **Anëtar**

Koli BELE - **Anëtar**

Ledio BRAHO - **Anëtar**